



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, par. 1, 2, 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), dhe të nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja a dhe të nenit 34, paragrafi 1, shkronja d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 19.05.2017, merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të "AL - TRADE" sh.p.k. dhe të Bajram (Nasuf) Gashanit.
- II. Vendimi i cekur në pikën I, nënkupton këmbimin e:
 1. Pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës së Prishtinës, pjesën e parcelës kadastrale nr. 965-0, ZK Matiçan, pjesën e parcelës 544-0, ZK Çagllavicë dhe pjesën e parcelës 941-1, me
 2. Pronën e paluajtshme në pronësi të "AL - TRADE" sh.p.k., pjesën e parcelës nr. 219-0, ZK Çagllavicë dhe pronën e paluajtshme në pronësi të Bajram (Nasuf) Gashanit, pjesët e parcelave nr. 238-1, 238-2, dhe 238-3, ZK Çagllavicë.
- III. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private.
- IV. Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues urban. Kjo i shërben shfrytëzimit për qëllime të interesit publik të Komunës dhe se kapitali për financimin e këmbimit është siguruar.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelave kadastrale që do të këmben.

- VI. Pronat e paluajtshme të cilat do të këmbehen, të përshkruara në piken II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria Kadastrit.
- VIII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë shkresat e lëndës.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/03-0118225/17, më 22.05.2017



KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS
Halim Halimi, jur. i dipl.